

Anketa e Buxhetit të Familjes, 2019

Tiranë, më 05 Tetor 2020: Në vitin 2019, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një NjEF, të përbërë mesatarisht nga 3,7 persona, janë 82.235 lekë. Totali i shpenzimeve për konsum është 63,5 miliardë lekë në muaj për 771.600 familje.

Vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve në vitin 2019, është 5,6 % më i lartë se në vitin 2018*. Rritja e çmimeve të konsumit, në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, është 1,4 %.

Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor, në vitin 2019, e ka shënuar grupi “Transport” me 5,5 %, krahasuar me vitin 2018*, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 54,3 %.

Tab.1 Struktura e shpenzimeve të konsumit të NjEF, 2018* - 2019

Grupet kryesore të konsumit	ABF 2018*		ABF 2019		Ndryshimi (%)
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	34.837	44,7	33.952	41,3	(2,5)
Pije alkoolike dhe duhan	2.644	3,4	3.077	3,7	16,4
Veshje dhe këpucë	3.263	4,2	4.289	5,2	31,5
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7.988	10,3	8.291	10,1	3,8
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	4.938	6,3	5.523	6,7	11,8
Shëndet	3.180	4,1	3.506	4,3	10,3
Transport	5.153	6,6	4.871	5,9	(5,5)
Komunikim	2.756	3,5	3.036	3,7	10,2
Argëtim dhe kulturë	2.038	2,6	3.143	3,8	54,3
Arsim	2.300	3,0	2.532	3,1	10,1
Restorante dhe hotele	3.567	4,6	3.988	4,9	11,8
Të tjera mallra dhe shërbime	5.202	6,7	6.027	7,3	15,9
Shpenzimet mesatare gjithsej	77.864	100,0	82.235	100,0	5,6

- **Shpenzimet e bëra në grupin “Argëtim dhe kulturë”** në vitin 2019 kanë pësuar rritjen më të lartë prej 54,3 %, krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të madhe të shpenzimeve për nëngrupet “pushime familjare brenda vendit dhe paketa turistike jashtë vendit”.

Për publikim 05/10/2020

* Të dhënat e vitit 2018 janë revizionuar për shkak të ndryshimit metodologjik të anketës (Ju lutem konsultohuni me ankesin e Metodologjisë, fq.5).

- **Shpenzimet e bëra në grupin “Veshje dhe këpucë”** kanë shënuar rritje prej 31,5 %, krahasuar me vitin 2018*, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve për nëngrupin “veshje”.
- **Shpenzimet e bëra në grupin “Pije alkoolike dhe duhan”** kanë regjistruar një rritje prej 16,4 %, krahasuar me vitin e kaluar, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve të nëngrupit “pije alkoolike”.


Sa i përket strukturës së shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve, sipas 12 grupeve kryesore të konsumit, peshën më të madhe e zënë grupet:

- **Grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”**, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 33.952 lekë, i cili zë një peshë prej 41,3 % në buxhetin familjar. Nëngrupet që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë “mish dhe nënprodukte” me 20,7 %, “perimet” me 18,1 %, “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” me 14,4 %, ndjekur nga “frutat” me 9,4 %.
- **Grupi i shpenzimeve për banesën**, me shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 8.291 lekë, përbën 10,1 % të totalit të buxhetit familjar.
- **Grupi “Të tjera mallra dhe shërbime”**, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 6.027 lekë, zë 7,3 % të buxhetit gjithsej. Peshën më të madhe brenda këtij grupi e përbëjnë shpenzimet për “artikuj dhe produkte për kujdes personal”, me 51,0 %.

Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, 2019

Në vitin 2019, qarku i Tiranës paraqet shpenzimet mesatare më të larta mujore për konsum. Një NjEF në qarkun e Tiranës shpenzon për konsum mesatarisht 98.402 lekë në muaj. Qarqet që paraqesin shpenzimet mesatare më të larta për konsum, pas qarkut të Tiranës, janë Korça me 82.224 lekë dhe Fieri me 79.620 lekë në muaj për NjEF. Qarqet me nivel më të ulët të shpenzimeve mesatare mujore për konsum janë qarku i Dibrës me 67.805 dhe i Elbasanit me 68.903 lekë në muaj për NjEF. Rritjen më të madhe të shpenzimeve e paraqet qarku i Dibrës me 12,3 %, ndjekur nga qarku i Fierit me 9,2 %. Qarqet që kanë pësuar ulje të shpenzimeve për konsum janë: Durrësi me 1,6 % dhe Vlora me 0,5 %.

Fig.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2019



Në vitin 2019, numri mesatar i anëtarëve të NjEF është 3,7. Qarku me numrin më të madh të anëtarëve të NjEF është Kukësi me 4,3 anëtarë, ndërsa Gjirokastra është qarku me numrin më të vogël të anëtarëve në përbërjen e NjEF, me 3,2 anëtarë.

Tab.2 Madhësia mesatare e NjEF, sipas qarqeve, 2019

Qarku	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastër	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Shqipëri
Madhësia mesatare e NjEF	3,5	4,0	3,8	3,7	3,7	3,2	3,4	4,3	3,9	3,8	3,7	3,4	3,7

Shpërndarja e shpenzimeve mesatare të konsumit sipas tipit të NjEF, 2019

Në 2019, në NjEF-të e përbëra nga një person i vetëm, grupi ushqim zë peshën më të madhe prej 44,8 %, krahasuar me tipet e tjera. Peshja më e lartë për shpenzimet për transport është regjistruar në strukturën e buxhetit të NjEF-ve të përbëra nga tri ose më shumë të rritur pa dhe me fëmijë, përkatësisht 6,5 dhe 6,4 %. Në NjEF-të e përbëra nga tri ose më shumë të rritur me dhe pa fëmijë në varësi peshja që zënë shpenzimet për arsim është më e lartë krahasuar me tipet e tjera.

Tab. 3 Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit sipas tipit të NjEF në %, 2019

Grupet kryesore të konsumit	Tipi i Njesisë Ekonomike Familjare						Gjithsej
	Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tri ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tri ose më shumë të rritur me fëmijë	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	44,8	43,0	44,7	41,1	39,7	40,6	41,3
Pije alkoolike, duhan	2,7	1,3	3,7	3,4	3,9	4,0	3,7
Veshje dhe këpucë	3,7	6,9	4,1	5,7	5,1	5,7	5,2
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar	13,4	14,8	11,9	10,9	9,6	8,7	10,1
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës	5,8	7,5	7,2	6,5	6,6	6,7	6,7
Shëndet	6,2	2,7	5,9	3,1	3,8	4,2	4,3
Transport	3,5	4,2	4,6	5,8	6,5	6,4	5,9
Komunikim	3,9	3,9	4,0	3,5	3,8	3,5	3,7
Argëtim dhe kulturë	3,5	3,8	2,9	4,7	3,9	3,8	3,8
Arsim	0,3	1,2	0,6	2,6	4,2	3,9	3,1
Restorante dhe hotele	6,4	3,2	4,3	4,5	5,6	4,5	4,9
Të tjera mallra dhe shërbime	5,8	7,5	6,2	8,1	7,2	7,8	7,3
Shpenzimet për konsum gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0

Metodologjia

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Anketa e Buxhetit të Familjes u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009 dhe që nga viti 2014 e vazhdueshme. Nga viti 2006-2007 anketa është gjithëpërfshirëse për të gjithë territorin e Shqipërisë duke përfshirë zonat urbane dhe rurale si dhe me përfaqësim në nivel qarku, Anketa e Buxhetit të Familjes 2019 u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 9.360 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 7.235 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë, shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 77,3 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 12 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Totali i NjEF të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të bërë të mundur pasqyrimin e ndryshimeve stinore. Si rrjedhim, janë anketuar çdo muaj rreth 782 NjEF të shpërndara njëtrajtësisht në të gjitha zonat e zgjedhura, për të siguruar përfaqësimin e çdo zone në të gjithë muajt e vitit.

Ndryshime Metodologjike

Në zbatim të standarteve ndërkombëtare, INSTAT në bashkëpunim me ekspertë Suedezë studioi efektin e ndryshimit të metodës së mbledhjes së të dhënave nga 2 në 1 javë në ditarin e blerjeve.

Për shkak të ndryshimit të mbledhjes së të dhënave, të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes 2018, janë revizionuar dhe kanë sjellë efekt në treguesit e konsumit.

Revizionimi i të dhënave si rrjedhojë e ndryshimeve metodologjike gjithashtu janë rekomandim në zbatim të politikës së revizionimeve të miratuar nga INSTAT.

http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf.

Revizionimi i të dhënave të vitit 2018 mundëson ruajtjen e krahasueshmërisë së të dhënave me vitin 2019 e në vijim.

Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:

- Plotësimi i një ditari nga ana e NjEF ku regjistrohen shpenzimet për blerje produktesh/shërbimesh të konsumit të gjerë si dhe, sa herë që plotësohen kushtet, plotësimi i një ditari të veçantë për autokonsum ku familja regjistron vetëm produktet e prodhuara dhe të konsumuara gjatë ditëve të referencës, vlerësuar me çmimin që do të kishte paguar për t'i blerë në dyqanin më të afërt;
- Kryerja e një interviste direkte nga anketuesit nëpërmjet një pyetësi ku përfshihen pyetje mbi shpenzimet me vlerë më të madhe dhe me frekuencë blerjeje më të rrallë, të grupuara dhe të ndara sipas temave të veçanta, Në të njëjtin pyetësor janë përfshirë edhe pyetjet mbi të dhënat socio-demografike të anëtarëve të NjEF që do të shërbejnë gjatë analizës së buxhetit familjar sipas tipologjive të NjEF;
- Periudha e referencës së mbledhjes së të dhënave për studimin e vitit 2019 ndryshon nga vrojtimitet e mëparshme të buxhetit të familjeve, ku ditari dhe fletorja e vetë-konsumit mbledh të dhëna me periudhë reference 1 javë për të gjithë kampionin.

Përkufizime:

Shpenzimet për konsum të NjEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012.

Periudha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni, Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Kryefamiljari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF), Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.

Fëmijë është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.

Aneksi 1 - Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)

Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	
KATEGORITË	Disa detaje përsa i perket zërave në çdo kategori të cilat shërbejnë vetëm për konsum familjar.
1 - USHQIME DHE PIJE JO-ALKOOLIKE	Produktet ushqimore të klasifikuara këtu janë ato të blera dhe të prodhuara për konsum në shtëpi.
	Grurë, Misër, Oriz, Miell dhe nënprodukte të tij, Bukë, Mish, Peshk, Produkte të tjera deti, Vaj, Fruta, Perime, Qumësht, Djathë, Gjalp, Gjizë, Vezë, ujë mineral dhe me gaz, lengje frutash, Kafë, Caj, Mjalt, Produkte Sheqeri, Te gjitha produktet e kesaj kategorie te prodhuara nga vete familja et.
2 - PIJE ALKOOLIKE DHE DUHAN	Pijet alkoolike të klasifikuara këtu janë ato që zakonisht blihen për konsum në shtëpi.
	Verë, Birrë, Raki, Whisky, Të gjitha llojet e Likernave, Uzo dhe pije të tjera gjallëruese Duhan, Cigare, Puro, Letër cigare, Filtër etj.
3 - VESHJE DHE KËPUÇË	Në këtë zë përfshihen veshje, këpucë, të reja apo të përdorura, materiale për veshje, dhe riparimi i tyre, etj.
	Veshje për burra, gra, fëmijë (3 deri 13 vjeç) dhe foshnja (0 deri 2 vjeç), qofshin të gatshme ose të bëra me porosi, në të gjitha materialet (përfshirë lëkure, gëzof, plastike dhe gome), të përditëshme, për sporte ose për punë: pardesy, mantele shiu, bluza, xhupa, xhaketa, pantallona, kostume, fustane, funde, etj, Këmisha, bluza, pulovra, bluza pas trupit, pantallona të shkurtra, roba banje, tuta, kostume vrapimi, geta, etj, Jelek, të brendëshme, çorape, streçe, geta, sutiëna, funde me palë, të brendëshme me tantellë, fustane nate, breza, korse, çorape të thurura, etj, Bizhama, bluza nate, robdishane, kostume banje, xhaketa për shtëpi, etj, Veshje për fëmijë dhe çorape të thurura për fëmijë.
4 - STREHIMI, UJI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE LËNDE TË TJERA DJEGËSE	Në këtë zë përfshihen: Qiraja e paguar (si shpenzim i kryer efektivisht për marrjen e ambienteve të banimit me qira nga ana e NjEF), mirëmbajtja dhe riparimi i banesës, materiale për riparim, pagesa për energji elektrike: ujë, gaz, hecje plerash, dhe të gjitha pagesat që kanë lidhje me banesën e familjes etj.
5 - MOBILJE, PAJISJE PËR SHTËPINË DHE MIRËMBAJTJA E ZAKONSHME E SHTËPISË	Në këtë zë përfshihen: Krevate, sofa, divane, tavolina, karrige, bufe, komo dhe raftë librash, pajisjet e ndriçimit si abazhurë tavanesh, llampa standart, në formë globesh, dhe abazhurë komodinash, të gjitha llojet e tekstileve për shtëpi, pajisje elektroshtëpiake, pajisje dhe vegla për kopshtin, tapete, riparimi i tyre, pagesa për kopshtar, guzhiniere, dado etj.
6 - SHËNDETI	Ky grup mbulon ilaçet, protezat, makinë të dhe pajisjet mjekësore si dhe produkte të tjera të lidhura me mjekimin të blera nga individët, me dhe pa recetë, zakonisht nga furnizuesit e ilaçeve, aparatura dhe pajisje terapeutike, të gjitha llojet e shërbimeve mjekësore përfshirë dhe ato ambulatorie etj.
7 - TRANSPORTI	Të gjitha llojet e makinave, të reja dhe të përdorura, taxi, Bileta avionësh, të gjitha llojet e biletave Naftë, Gas, Pjesë këmbimi dhe riparime, Garazhde, etj.
8 - KOMUNIKIMI	Shërbime postare, të gjitha llojet e shërbimeve për komunikim, telefona, celularë, fax, internet etj.
9 - ARGËTIMI DHE KULTURA	Në këtë zë përfshihen të gjitha llojet e pajisjeve audio-vizuale, Aparate marje, regjistrimi dhe riprodhimi të tingujve dhe filmave, Pajisjet e përpunimit të informacionit, Pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumente optike, Të mira afatgjata për argëtim në ambientet e jashtme, Pajisjet kryesore për lojra dhe sport, Bileta, lojra fati, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre etj.
10 - ARSIMI	Kjo ndarje përfshin vetëm shërbimin e arsimit.
	Klasifikimi i shërbimeve të arsimit bazohet në kategoritë sipas niveleve të Klasifikimit Standart Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO). Përfshihen: Arsimit parashkollor dhe fillor, Arsimit 8/9 vjeçar dhe i mesëm, Arsimit parauniversitar, Arsimit i lartë, Arsimit i papërcaktuar në nivele (Kurse arsimit).
11 - RESTORANTE DHE HOTELE	Në këtë zë përfshihen: Restorante, bare dhe të tjera si këto, Shërbimet e akomodimit, menca, etj, Përfshihen: shërbime të shpërndarjes së produkteve ushqimore (ushqime, meze, pije dhe pije freskuese) të ofruara nga restorantet, kafenet, bufetë, baret, etj, Hotele, motele, hane dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Qendra pushimesh, vende për kamping, bujtina për të rinjtë dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Shërbimet e akomodimit të institucioneve të tjera.
12 – TË MIRA DHE SHËRBIME TË NDRYSHME	Në këtë zë përfshihen: Sallone bukurie dhe institucione të kujdesit personal, Pajisje elektrike dhe jo-elektrike për kujdes personal, riparimi i pajisjeve për kujdes personal, Sende personale, Përkrahja sociale, Sigurimi, Shërbime financiare të specifikuar, Shërbime të tjera të paspecifikuara etj.